



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
OSNOVNI SUD U PRIZRENU – BASIC COURT OF PRIZREN

AD-GJTHPZ.nr.14/23

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN, Kryetarja e gjykatës Shpresa Emra, duke vepruar sipas kërkesës për inicim të procedurës disiplinore të parashtruar nga ana e ankueses L.Ç., nga Prizreni, ndaj gjyqtarës E.S., gjyqtare në Gjykatën Themelore në Prizren, Departamentin e Përgjithshëm - Dvizioni Civil, lidhur me veprimet dhe sjelljen e Gjyqtarës së lartcekur sipas lëndës C.nr.57/18, në bazë të së cilës është bërë inicimi i procedurës disiplinore, me dt.21.08.2023 mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e ankueses L.Ç., nga Prizreni, ndaj gjyqtarës E.S., gjyqtare në Gjykatën Themelore në Prizren, Departamentin e Përgjithshëm Divizioni Civil.

A r s y e t i m

Parashtruesi i ankesës L.Ç., nga Prizreni ka parashtruar Ankesë në Ministri të Drejtësisë në lidhje me lëndën civile në Gjykatën Themelore në Prizren e cila më pas është përcjellë në Këshillin Gjyqësor të Kosovës dhe është trajtuar si Kërkesë për inicim të procedurës disiplinore ndaj gjyqtarës E.S., gjyqtare në Gjykatën Themelore në Prizren, Departamentin e Përgjithshëm-Divizioni Civil, lidhur me lëndën civile C.nr.57/18.

Me të pranuar ankesën si autoritet kompetent kam iniciuar procedurën hetimore për rastin disiplinor dhe kam kërkuar nga ankuesja L.Ç., të dorëzojë provat të cilat i ka cekur në ankesën e saj (ku ka cekur "Unë i kam të gjitha provat. Gjykata e Prizrenit janë korruptuar nga familja B....") e të cilat nuk kanë qenë të bashkangjitura me ankesë. Me dt. 11.08.2023 në mënyrë elektronike kemi pranuar provat e kërkuara. Ankuesja ka një lëndë në Gjykatën Themelore të Prizren të evidentuar me numër C.nr.57/18 për vërtetim të pronësisë në të cilën paraqitet si paditëse me avokat D.D., nga Gjakova kundër të paditurit A B...., nga Prizreni me avokat D.N.; nga Prizreni. Lënda ka përfunduar dhe gjykata ka vendosur me Aktgjykim . Pasi që i është refuzuar kërkesa ankuesja pretendon se i është shkelur e drejta në pronësi dhe se nuk do të ndaloj së kërkuari këtë të drejtë dhe për këtë ka informuar edhe Kryeministrin , Gjykatën e Apelit, Gjykatën Supreme dhe është e gatshme të dërgoj edhe në Gjykatën e Strasburgut. Ankuesja L.Ç., ka qenë e martuar me B B.... nga Prizreni që nga viti 2003-2010(vëllau A B...., në çështje i paditur) i cili ka vdekur me 14 gusht 2010.Në vazhdim ka cekur se gjykata pretendon se ajo ka qenë e shkurorëzuar nga B.i, por se ajo për shkak se shteti Gjerman nuk e ka pranuar këtë martesë është dashur që të prishi të njëjtën dhe se ata janë kurorëzuar sërish me dt. 27.08.2003. Me bashkëshortin e saj tani të ndjerë ankuesja ke cekur se ka financuar blerjen e tre trualli dhe se në të njëjtat më pas kanë financuar edhe ndërtimin e tre shtëpive të cilat A B.... në vitin 2012 i ka bartur në emrin e tij dhe e gjithë familja

B.... nuk e konsideron se bashkëshorte e të ndjerit B. dhe si trashëgimtare ligjore e tij. Sipas saj i janë shkelur të gjitha të drejtat në pasuri të saj dhe se shumë persona në Institucionit kryesore në PRizren janë korruptuar përndryshe nuk do të ishim marr vendime të tilla . Provat të cilat i ka dërguar ankuesja janë të gjitha në gjuhën gjermane dhe paraqesin disa fletëpagesa në emër të saj , një plan të ndërtimit të një shtëpie dhe disa dokumente të lëshuara nga shteti Gjerman në emër të B B.....

Gjyqtarja E.S., ka dhënë deklaratë në lidhje me lëndën civile C.nr.57/18 ku ka cekur se në këtë çështje ka vendosur si gjyqtare e çështjes ku si palë paditëse ka qenë L.Ç., nga Fieri Republika e Shqipërisë, me vendbanim në Gjermani, me avokat D.D., , kurse si palë e paditur ka qenë A., B...., nga Prizreni, me avokat D.N., nga Prizreni. Lënda e kontestit ka qenë vërtetim pronësie. Kjo lëndë ka përfunduar me Aktgjykim C.nr.57/1 8 ku pala paditëse(ankuesja) ka parashtruar ankesë dhe lënda në afatin ligjor do të dërgohet në Gjykatën e Apelit sipas ankesës. Sa i përket pretendimeve të paditëses ka deklaruar se ajo nuk e njeh familjen B...., i njeh vetëm si palë sipas kësaj lënde. Ka cekur se është e pakuptimtë se si është parashtruar kjo kërkesë pa kurrfarë prove dhe baze, vetëm sepse gjykata nuk ka vendosur në favor të paditëses. Në këtë çështje gjyqtarja ka deklaruar se ka proceduar me paanshmëri dhe duke u bazuar në prova të bashkangjitura dhe në ligj me qëllim të vërtetimit të drejtë të gjendjes faktike dhe ndarjen e drejtësisë në mënyrë sa më të drejtë. Gjithsesi pala paditëse respektivisht i autorizuari i saj ka parashtruar ankesë kundër aktgjykimit për të cilën do të vendosi shkalla e dytë Gjykata e Apelit.

Autoriteti kompetent - Kryetarja e gjykatës pasi që ka pranuar ankesën drejtuar Këshillit Gjyqësor të Kosovës, ka iniciuar hetimet preliminare për procedurë disiplinore dhe ka ndërmarrë disa veprime në këtë drejtim. Fillimisht ka bërë shikimin në ankesën e parashtruar, ka kërkuar deklaratë nga gjyqtari i çështjes E.S., ka bërë verifikimin e shkresave të lëndës C.nr.57/18. Pas vlerësimit dhe analizës së tërësishme të provave të mbledhura Autoriteti Kompetent konsideron se:

Ankesa është e pabazuar.

Autoriteti kompetent - Kryetarja pas verifikimit të gjithë dokumentacionit ka vërtetuar gjendjen faktike si vijon:

Ankuesja ka vërejtje në punën e gjyqtarit E.S., lidhur me lëndën civile C.nr.57/18 dhe në punën e tërë Gjykatës Themelore në PRizren . Në ankesën e saj ka deklaruar "Unë i kam të gjitha provat . Gjykata e Prizrenit janë korruptuar nga familja B....". Bazuar në këtë deklaratë si Autoritet kompetent kam kërkuar që të dërgohen këto prova në mënyrë elektronike , ku e njëjta ka dërguar disa shkresa të cilat janë bashkangjitur me ankesën e saj.

Konkretisht ankesa ka të bëjë me lëndën civile C.nr.57/18 ku si palë paditëse ka qenë L.Ç., nga Fieri Republika e Shqipërisë, me vendbanim në Gjermani, me avokat .D.D., , kurse si palë e paditur ka qenë A., B...., nga Prizreni, me avokat D.N., nga Prizreni. Lënda e kontestit është vërtetim pronësie. Kjo lëndë ka përfunduar me Aktgjykim C.nr.57/18 ku është refuzuar kërkesëpadia e paditëses L.Ç., për vërtetim të pronësisë, dhe pala e njëjta ka parashtruar ankesë dhe lënda në afatin ligjor do të dërgohet në Gjykatën e Apelit në vendosje.

Duke u nisur nga fakti se ankuesja ka cekur se e gjithë gjykata është e korruptuar nga familja B.... si autoritet kompetent kam kërkuar prova sa i përket elementeve të cilat karakterizojnë veprimet korruptive, por nga ankuesja kam pranuar disa prova që kanë të bëjnë me vërtetimin e çështjes dhe gjendjes faktike të cilat të gjitha kanë janë në gjuhën gjermane dhe të cilat duhet të përdoren në procedurë të vërtetimit të pronësisë në shkallën e parë ose të dytë sipas ankesës. Sa i përket provave që kanë të bëjnë me korrupsion nga ana e gjyqtarës së çështjes ose nga ana e gjykatës nuk kam pranuar asnjë provë konkrete .Provat të cilat vërtetojnë korrupsionin janë prova të cilat kanë të bëjnë me ndonjë e dhënë, përfitim material, favor ose ndonjë veprim tjetër që është paraparë

sipas Kodit Penal të Kosovës dhe të njëjtat duhet të kenë mbështetje dhe autenticitet në provimin e tyre si dhe lidhshmëri kauzale me personin për të cilin pretendohet se ka korrupsion . Nëse thuhet se "Gjykata është e korruptuar " duhet të provohet dhe të arsyetohet , gjë që në rastin konkret nuk është bërë.

Autoriteti Kompetent konsideron se nuk ka prova të cilat vërtetojnë pretendimet e ankueses në lidhje me veprimet korruptive të gjyqtarës si dhe krejt gjykatës sepse provat e bashkangjitura kanë të bëjnë me vërtetim të gjendjes faktike sipas lëndës C.nr.57/18. Gjyqtarja e çështjes ka vendosur me Aktgjykim ndaj të cilit i autorizuari i paditëses në rastin konkret ankueses ka parashtruar ankesë në Gjykatën e Apelit dhe lënda është përgatitje të dërgimit sipas ankesës. Andaj konsiderojmë se kemi të bëjmë me ankesë për shkelje të dispozitave të procedurës dhe nuk kemi prova të cilët na tregojnë se kemi të bëjmë me shkelje disiplinore të cilat i ka kryer gjyqtari i çështjes .

Për arsytet që u cekura më lartë, Autoriteti Kompetent — Kryetarja e Gjykatës ka vendosur si në dispozitiv të aktvendimit në kuptim të nenit 9 paragrafi 6 lidhur me nenin 17 paragrafi 5 të Ligjit nr.06/L-057 për përgjegjësinë disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN

AD-GJTHPZ.nr.14/23, me dt. 21.08.2023



KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi, nuk është e paraparë e drejta e ankesës.